

URDHËR
Nr. 1195, datë 10.11.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të gurmës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, ”Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të gurmës “c”, të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, ”Për Kadastrën”; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, ”Kodi i Procedurave Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave znj. Nertila Mihali, drejtor i Drejtorisë së Investimeve dhe Shërbimeve, për sa vijon:

- Për të trajtuar dhe nënshkruar aktet dalëse, lidhur me korrespondencën me institucionet e varësisë dhe dhënien e orientimeve për problematika të ndryshme që lidhen me specifikat e sektorit (mirëmbajtjen e ambienteve edhe mirëadministrimin e aseteve të paluajtshme të institucionit, sigurinë e ambienteve në bashkëpunim me strukturat e tjera, plotësimin e nevojave të institucioneve me mjete pune, pajisje, kancelari, etj.);

- Për të trajtuar dhe nënshkruar aktet për shpërndarjen e pajisjeve kompjuterike, orendi e pajisje të tjera, kancelari, materiale pastrimi, tonera, etj., për drejtoritë/zyrat vendore të ASHK-së dhe Drejtorinë e Përgjithshme, bazuar në kërkesat e tyre dhe gjendjen e magazinës së Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së;

- Për të nënshkruar autorizimet për lëvizjen e automjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme, si dhe aktet për shpërndarje karburanti në bazë të normativës së konsumit për çdo automjet për nevoja të lëvizjes së strukturave të institucionit për nevoja pune ose në mbështetje të urdhrave të punës/shërbimit të miratuar nga drejtori i përgjithshëm;

- Për të trajtuar kërkesat dhe nënshkruar aktet dalëse për shpërndarjen e karburantit për furnizimin me karburant të gjeneratorëve, në mbështetje të normativës së konsumit;

- Për të trajtuar kërkesat për kopje dokumentacioni të dosjeve personale të punonjësve të ASHK-së dhe nënshkrimin e kthimpërgjigjeve të këtyre kërkesave;

- Për të trajtuar dhe nënshkruar vërtetimet e punës për punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së;

- Për të nënshkruar shkresat dalëse përcjellë Departamentit të Administratës Publike për formularët e dekriminalizimit të punonjësve.

2. Pavarësisht delegimit të kompetencave sipas këtij urdhri, drejtori i Drejtorisë së Investimeve dhe Shërbimeve, nëse e gjykon të nevojshme, mund t’i përcjellë për nënshkrim drejtorit të përgjithshëm shkresat që i vlerëson të një rëndësie të veçantë.

3. Delegimi i kompetencës sipas këtij urdhri nuk përfshin aktet administrative dhe detyrat të cilat duhet të miratohen dhe të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

4. Në rast mungese në detyrë të drejtorit të Drejtorisë së Investimeve dhe Shërbimeve, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës, në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “c”, e Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë mungesës kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.

5. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri të ushtrohet duke filluar nga data e miratimit të këtij urdhri deri në shfuqizimin e tij.

6. Ngarkohet Drejtoria e Investimeve dhe Shërbimeve dhe znj. Nertila Mihali, dhe Sektori i Arkiv Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli